

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PDK-ja e kundërshton në Kushtetuese zgjedhjen e Qeverisë së re
ADRESA	https://dosja.al/politike/pdk-ja-e-kundershton-ne-kushtetuese-zgjedhjen-e-qeverise-se-re-i514243
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 12:03:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 11:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	32d07a8571fbd2dc4f1b5e13392b3ab80f8a0f35845f9165c8ad8ee088477bbc
TEKSTI	f8418221aae8e1b1be7ff1844e252be2a0d7e46fbca850619779f9e68884cd85
PAMJA	f16c9b28791a33ad47ca14eeafa2a4c50352ac90302274a47f7fccab50b0801a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9432822215ecbac308a38d0da077eb2463279b36a175c958bc81bc1f69113d28
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5f8ef0f8d1c556c1a23c45b5f0b4a2927fefdb161a9dff8be1ca6faf0b0d4224
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/9432822215ecbac308a38d0da077eb2463279b36a175c958bc81bc1f69113d28

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

2 ORE ME PARE

Rekursi i Vellajt në Gjykatën e Lartë/ GJL ië fuqi vendimin e GJKKO-së, Erion Vellaj mbetet në burg

17 ORE ME PARE

107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

18 ORE ME PARE

Më 16 shtator jepet vendimi për Thačin dhe ish-krerët e UÇK-së/ Kurti: Uroj të kthehen të lirë. Ambasada e SHBA në Prishtinë: Priten protesta, kini kujdes

23 ORE ME PARE

"Në epigjendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

Politike

PDK-ja e kundërshton në Kushtetuese zgjedhjen e Qeverisë së re

Deputetët e PDK-së, Përparim Gruda dhe Arian Tahiri, iu drejtuan të martën Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për ta vlerësuar votimin, një ditë pasi i kërkuar asaj të vendosë masë të përkohshme ndaj Kuvendit.



15 Shtator 2026, 13:50
Nga E.d



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti

Partia më e madhe opozitare në vend, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i ka kërkuar gjykatës më të lartë të vendit ta shqyrtojë nëse Qeveria e re e Kosovës është zgjedhur në mënyrë të ligjshme, duke thënë se ajo u votua nga një Kuvend i "pa konstituuar".

Kuvendi i Kosovës e votoi Qeverinë e re duke e zgjedhur Albin Kurtin kryeministër për herë të katërt të dielën, pak orë pasi ishte konstituuar legjislatura e 11-të mes polemikave dhe akuzave për shkelje kushtetuese gjatë procesit.

Deputetët e PDK-së, Përparim Gruda dhe Arian Tahiri, iu drejtuan të martën Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për ta vlerësuar votimin, një ditë pasi i kërkuar asaj të vendosë masë të përkohshme ndaj Kuvendit.

"Sot e kemi kontestuar vendimin e Kuvendit për ta zgjedhur Qeverinë e re të Kosovës, sepse ne konsiderojmë se Kuvendi është konstituuar duke e shkelur Kushtetutën", tha Gruda për media.

Ai nguli këmbë se "një Kuvend që është konstituuar në mënyrë jokushtetuese" nuk mund ta zgjedhë një qeveri kushtetuese.

"Argumentet tona janë profesionale dhe deri në fund kushtetuese dhe jemi të bindur se do të merren parasysh nga Gjykata Kushtetuese", theksoi Gruda.

Ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, i tha Radios Evropa e Lirë se në konstituimin e Kuvendit pati shkelje të Kushtetutës dhe se një vendim që do ta konstatonte këtë, do të mund të vinte në pikëpyetje edhe zgjedhjen e Qeverisë Kurti 4.

editoriale

Irena Begiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 13:44

Skema se si IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

ART&ARGËTIM 15 SHTATOR 2026, 10:17

Matthew Rhys bën histori në Emmy Awards, bëhet aktori i parë që fiton dy çmime kryesore në një natë

Si u konstituua Kuvendi?

Kuvendi u shpall i konstituuar të dielën paradite, pasi u zgjodhën nënkryetarët nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe komuniteteve pakicë.

Kryetarja dhe nënkryetari i parë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në pushtet ishin zgjedhur në seanca të mëparshme të mërkurën dhe premten, përkatësisht.

PDK-ja nuk mori pjesë në seancë dhe paraprakisht e kishte tërhequr kandidaturën e Vlorë Çitakut për nënkryetare, kur LVV-ja nuk ia kishte votuar në seancën e të premtes.

LVV kishte thënë të shtunën vonë se do ta votonte Çitakun. Por, PDK nuk pranoi të merrte pjesë.

Kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, tha se Kuvendi “nuk mund të mbetet peng i askujt, i asnjë subjekti politik”, dhe e vazhdoi procesin.

Kandidati i LDK-së për nënkryetar, Kujtim Shala, u zgjodh me 75 vota.

Pas tetë kandidaturave të dështuara nga Lista Serbe, u zgjodh edhe deputetja serbe Tanja Vujović. Nga komunitetet joserbe u zgjodh deputetja boshnjake Emilija Rexhepi.

Pas votimit të nënkryetarëve, Haxhiu deklaroi se Kuvendi “konsiderohet i konstituuar”.

Disa orë më vonë, Kuvendi u mbledh sërish dhe e zgjodhi Qeverinë e re, në një seancë të braktisur nga PDK, Aleanca dhe LDK.

PDK-ja argumenton se pushteti e shkeli Kushtetutën duke shpërfillur afatet kushtetuese për procesin e konstituimit të organit ligjvënës.

Ajo pretendon se është shkelur afati kushtetues prej 30 ditësh për konstituimin e Kuvendit dhe procedurën për thirrjen e seancës çdo 48 orë deri në konstituimin e tij.

Një aktgjykim i vitit të kaluar i Gjykatës Kushtetuese thotë se Kuvendi duhet të konstituohet brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultateve. Ky afat përfundoi më 7 gusht 2026.

Sipas Hasanit, konstituimi i Kuvendit të dielën “nuk ka ndjekur asnjë rrugë kushtetuese” të përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës, në veçanti me nenin 67 të saj, me nenin 12 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, si dhe me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese që i kanë interpretuar këto dispozita në të kaluarën.

“Nuk do të ishte profesionale që gjykata, tani kur çështja është e qartë, të lejonte funksionimin e Kuvendit të Kosovës, i cili, sipas këtyre parametrave kushtetues, është konstituuar në shkelje të Kushtetutës”, tha Hasani./REL

kuvendi i kosovës

albin kurti

pdk

Sondazh

Poll

ART&ARGËTIM 15 SHTATOR 2026, 10:15

FOTO/ Zendaya, Selena Gomez dhe yjet e Hollywood-it shkëlqejnë në tapetin blu të Emmy Awards

më të klikuarat



Pse bën foto? Rama kap të riun nga qafa dhe ia dorëzon policisë, çfarë ndodhi në Aeroportin e Napolit? (VIDEO)

"Mbaje mend do të vras"/ Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa, Policia: Materialet u referuan në Prokurori për 3 vepra penale

Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Gruaja: Hotelin ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë

Ilir Meta del nga kafazi/ Apeli i GJKKO pranon kërkesën: Gjatë seancave do qëndrojnë krah avokatit

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by  tomorrow

Politike

15 Shtator 2026, 13:25

Pagat e gjyqtarëve/ Ministri Gogu: Vonesa e Kuvendit nuk duhet të krijojë përplasje mes pushteteve

Toni Gogu TIRANA- Ministri i Drejtësisë, Toni Gogu ka folur në lidhje me pagat e gjyqtarëve, duke thënë se vonesa e...

"Paga bruto e një magjistari" / Gafat e njëpasnjëshme të deputetes socialiste: Mos e bëni kaq të madhe, është laps

Politike

15 Shtator 2026, 13:00

PD: Nafta në Shqipëri 2.48 euro, më e shtrenjtë se në Gjermani dhe Norvegji, përgjegjës për këtë është vetëm Edi Ramës

Politike

15 Shtator 2026, 13:12

Erion Veliaj u la në burg/ Avokati Ndreca: Gjykata e Lartë la në fuqi një vendimmarrje të shfuqizuar nga Kushtetuesja, po mbajnë peng ushtrimin e mandatit të tij

Politike

15 Shtator 2026, 12:33

"Marr armë nga Sudani"/ Çfarë fshihet pas përgjimit të Ron Yeffet? Industria sudaneze nën sanksione nga SHBA-BE, Timak Defence duhet të humbiste licencën

Politike

15 Shtator 2026, 12:09

Politike

15 Shtator 2026, 12:19

Kërkoi zëvendësimin e masës së sigurisë/ C IKKO

Kërkoi zëvendësimin e masës së sigurisë/ GJKKO rrëzon kërkesën e Ilir Metës, ish-presidenti mbetet në burg

Ilir Meta TIRANA- GJKKO ka rrëzuar kërkesën e ish-presidenti të vendit Ilir Meta i cili kërkoi zbutje të masës së ...

Vitin e ardhshëm zgjedhjet lokale/ Qeveria 'hap thesin' për pensionistët: Nga 1 janari do dyfishohet bonusi për të gjitha kategoritë

Politike

15 Shtator 2020, 12:08

Pagat e magjistratëve, Bardhi: Vendimin e GJK s'mund ta adresojnë as deputetët as punonjësit e administratës

Politike

15 Shtator 2020, 11:30

Veliaj mbetet në burg, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e kryebashkiakut

Politike

15 Shtator 2020, 11:06

Qeveria e Ramës i dha 4 mln euro nga fondi i emergjencave/ Der Spiegel: Kanye West pritet të performojë në Rusi, si po e përdor Kremlinin për të rekrutuar njerëz në luftë

Politike

15 Shtator 2020, 10:46

MË SHUMË



"Paga bruto e një magjistari"/ Gafat e njëpasnjëshme të deputetes socialiste

Shiko video te tjera

[KTHEHU NE KRYE](#)

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [\[email protected\]](#)

[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)[AKTUALITET](#)[POLITIKE](#)[EKONOMI](#)[BOTA](#)[SPORT](#)[ART&ARGËTIM](#)[INSIGHTS](#)[EDITORIAL](#)**Drejtör:** [Enton Abilekaj](#)**Kryeredaktor:** [Izmir Akulli](#)**Gazetarë:**[Esmeralda Doçi](#)[Emanuela Dida](#)[Elisa Karaj](#)[Dorotea Simoni](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.